



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË

V E N D I M

Nr. 26/1 dt.14.02.1996

MBI FONDET PER LIRIMIN E AMBJENTEVE TE N.T.P.N
PER SHESH NDERTIMI.

Këshilli Bashkiak i Tiranës, i mbledhur sot me dt.14.02.1996, pasi shqyrtoi relacionin e paraqitur nga Drejtoria e Shërbimeve Publike, mbi çeljen e fondeve për lirimin e ambjenteve të N.T.P.N për shesh ndërtimi, në bazë të ligjit Nr.7672,dt.10.06.1992 “Për organizimin dhe funksionimin e Pushtetit Lokal”, dhe të vendimit të K.M. Nr.158, dt.11.04.1994 “Për kriteret e përdorimit të të ardhurave të pushtetit lokal”,

VENDOSI

1. Për evadimin e materialeve nga dyqanet e N.T.P.N, të cilat do të lirohen për shesh ndërtimi, në objektet e caktuara për organizimin e tyre si dhe sistemimin e tyre, të cilat nga të ardhurat e Bashkisë një fond prej 787.614 lekë.
2. Fondet e caktuara për këtë qëllim do ti çelen firmës Albakonstruksion (e cila në bazë të marrëveshjes së nënshkruar midis Bashkisë së Tiranës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të N.T.P.N për evadimin e materialeve të mësipërme) sipas situacioneve që do të miratojë Sektori i Ndërtimit në Drejtorinë e Shërbimeve Publike.

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Shërbimeve Publike e Drejtoria e Administrimit Fiananciare.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

BESNIK PETRELA